



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AKADEMISË SË DREJTËSISË PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Akademisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Akademisë së Drejtësisë (AD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Akademisë së Drejtësisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të AD kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Këshillit Drejtues është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Akademisë së Drejtësisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Akademisë së Drejtësisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Akademisë së Drejtësisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Akademisë së Drejtësisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Akademisë së Drejtësisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e pasurisë dhe auditimin e brendshëm.

Ky raport ka rezultuar me dy rekomandime dhe janë rekomandime të reja.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Pasuria kapitale neto e prezantuar në pasqyrat financiare është 58,086€, ajo jo kapitale 72,152€ dhe stoqet në vlerë 13,008€.

Çështja A1 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja Sipas rregullores MF 02/2013 Për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 6, përcakton së pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”, sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Ndërsa neni 24 obligon organizatat buxheore që pas barazimit të gjendjes me inventarizim dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurisë jo financiare, gjendja e pasurisë jo financiare duhet të jetë pjesë e PVF-ve.

Gjatë auditimit të mostrave për pasuri kemi vërejtur mangësi në menaxhimin e pasurisë kapitale dhe jo kapitale, si në vijimë:

- Projekti "Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për përkthim" në vlerë prej 48,549€ nuk është regjistruar plotësisht në regjistrin e pasurisë kapitale. Prej tyre, vetëm 11,007€ janë evidentuar në regjistrin e pasurisë kapitale, ndërsa 37,542€ janë evidentuar gabimisht në regjistrin nën 1,000€; dhe
- Në vitin 2014, komisioni i asgjësimit kishte rekomanduar asgjësimin e 310 aseteve, mirëpo gjatë auditimit, kemi identifikuar se llaptopi i përfshirë në këtë listë (edhe pse i asgjësuar) ende figuron në regjistrin e pasurisë jo kapitale.

Evidentimi i gabuar dhe mos shlyerja e pasurisë nga regjistrat ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarëve përgjegjës për regjistrimin e pasurisë dhe mungesës së kontrolleve të brendshme në nivel të organizatës.

Ndikimi Regjistrimi jo i duhur i pasurive dhe mosbarazimi i regjistrave rezultojnë me regjistra të pa saktë të pasurive si dhe prezantim jo të drejtë të informatave në PFV.

Rekomandimi A1 Kryesuesi i Këshillit duhet të forcoj kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive dhe të siguroj që pasuritë evidentohen në regjistrat përkatës sipas rregullave në fuqi dhe pasuritë e asgjësuar të largohen nga regjistri, me qëllim të raportimit të drejtë të pasurisë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Funkcioni i auditimit të brendshëm

Akademia e Drejtësisë nuk e ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm, sepse ka buxhet më pak se 3 milion, me ç'rast nuk përmbushet kërkesa ligjore për themelimin e NJAB.

Çështja A2 - Mos realizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm

Gjetja	Rregullorja nr. 01/2019 Për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 4, përcakton mënyrat e zbatimit të funksionit të auditimit të brendshëm.
	Gjatë vitit 2024 Akademia e Drejtësisë nuk ka arrit të siguroj shërbimet e auditimit të brendshëm. Nuk ka bërë kërkesë në Njësinë Qendrore Harmonizuese për sigurimin e këtij shërbimi, të krijoj njësi të përbashkët me ndonjë organizatë tjetër buxhetore, të bëjë marrëveshje për marrjen e shërbimit apo të kontraktoj shërbimin për auditim të brendshëm. Në mungesë të veprimeve sipas rregullores, AD nuk ka siguruar auditimin e sistemeve për menaxhimin financiar dhe kontrollit.
	Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së informatave, se si duhet vepruar kur organizata nuk i plotëson kriteret për themelimin e NJAB në kuadër të vet institucionit.
Ndikimi	Mungesa e raportit të auditimit të brendshëm, ndikon në mos identifikimin e magësive për të përmirësuar efektshmërinë e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.
Rekomandimi A2	Kryesuesi i Këshillit të siguroj zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në njërin nga mënyrat e përcaktuara sipas rregullores në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimin e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	863,245	739,710	667,320	749,942	608,366
Grante Qeveritare - Buxheti	863,245	735,600	663,277	732,858	583,759
Donacionet e jashtme	0	4,110	4,044	17,084	24,607

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 123,535€. Ky ndryshim ishte rezultat i zvogëlimit të buxhetit për 127,645€, me vendim të qeverisë nr. 14/238 për kursime buxhetore dhe rritjes me donacioneve për 4,110€.

Në vitit 2024, AD ka shpenzuar 90% të buxhetit përfundimtar ose 667,320€, me një rritje prej 6% krahasuar me vitit 2023.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	863,245	739,710	667,320	749,942	608,366
Pagat dhe mëditjet	276,797	254,652	254,449	229,115	212,550
Mallrat dhe shërbimet	519,948	424,058	353,818	415,541	388,200
Komunalitë	16,500	11,000	10,506	9,471	7,616
Investimet Kapitale	50,000	50,000	48,549	95,815	0

Shpjegimet për ndryshimin e buxhetit sipas kategorive janë dhënë më poshtë:


• Tek pagat dhe mëditjet, buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 22,145€. Ky ndryshim është rezultat i vendimit të qeverisë për kursime buxhetore, nr. 03/239, të datës 24.12.2024. Realizimi në këtë kategori është 254,449€ apo rreth 100%.

• Tek mallrat dhe shërbimet, buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 95,890€. Realizimi është rreth 83%.

• Tek komunalit, buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 5,500€. Realizimi për këtë kategori është 10,506€ apo rreth 96%.

• Tek investimet kapitale buxheti fillestar dhe buxheti final ka qenë i njëjtë, në vlerë prej 50,0000€, prej të cilave janë shpenzuar 48,549€ apo 97%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2023 të Akademisë së Drejtësisë ka rezultuar me dy rekomandime. AD kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, të dy rekomandimet janë zbatuar. Një përshkrim më i plotë i rekomandimeve dhe mënyra se si janë trajtuar shihni në Tabelën 4.


Tabela 3. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Kryesuesi i Këshillit të sigurojë që në një kohë sa më të arsyeshme dhe të afërt të zhvillojë procedurat konform kërkesave ligjore për plotësimin e pozitave udhëheqëse që mbahen me ushtrues detyre.	Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2024, pozitën e ushtruesit të detyrës e ka plotësuar me pozitë të rregullt.	I zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryesuesi i Këshillit duhet të sigurohet që, zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjeve bëhet para se të pranohen mallrat dhe faturat, në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohet rritja e detyrimeve të pa paguara.	AD ka ndërmarr veprimet që urdhërblerjet dhe zotimit të bëhen para pranimt të faturës.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Qëndresa Isufi, Udhëheqëse e ekipit



Luljeta Morina, Anëtare e ekipit



Albesa Tolaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

	<table border="1" style="margin: auto; border-collapse: collapse;"> <tr> <td colspan="4" style="text-align: center;"> REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA AKADHIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE </td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">Nëna, Org. Org. Jedis.</td> <td style="text-align: center;">02</td> <td style="text-align: center;">Nr. Prot. Pr. Prot.</td> <td style="text-align: center;">501</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">Nr. Faqeve Be. Stranica</td> <td style="text-align: center;">01</td> <td style="text-align: center;">Data Datum</td> <td style="text-align: center;">11.06.2025</td> </tr> <tr> <td colspan="4" style="text-align: center;">Prishtinë / g</td> </tr> </table>	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA AKADHIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE				Nëna, Org. Org. Jedis.	02	Nr. Prot. Pr. Prot.	501	Nr. Faqeve Be. Stranica	01	Data Datum	11.06.2025	Prishtinë / g					
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA AKADHIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE																			
Nëna, Org. Org. Jedis.	02	Nr. Prot. Pr. Prot.	501																
Nr. Faqeve Be. Stranica	01	Data Datum	11.06.2025																
Prishtinë / g																			
Republika e Kosovës Republika Kosovo/Republic of Kosovo <i>Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice</i> Këshilli Drejtues / Upravni Odbor/ Governing Board																			
LETËR E KONFIRMIMIT Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit Të nderuar, Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se: - kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Akademisë së Drejtësisë, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti"); - pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; - brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.																			
Enver Fejzullahu Drejtor Ekzekutiv Akademisë së Drejtësisë  Data: 11.06.2025																			

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.